

18.04.18

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

01-413101-10203

Prishtinë, __/__/2018

Nr.454/53

Në mbështetje të nenit 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Ligjin Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, lidhet kjo:

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
"NDËRTIMI I RRUGËS LOKALE NË QAFË PRUSH" KOMUNA E GJAKOVËS**

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),
dhe,
2. Komuna e Gjakovës përfaqësuar nga Kryetari Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit **“Ndërtimi i rrugës lokale në Qafë Prush”**, si dhe përcaktimi i obligimeve të MAPL-së dhe Komunës së Gjakovës, për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e financimit

1. Projekti **“Ndërtimi i rrugës lokale në Qafë Prush”** ka vlerën para llogaritave prej **208,058.00 €**.
2. MAPL nga buxheti i saj vjetor i vitit 2018, financon këtë projekt në shumën prej **108,000.00 €**.
3. Komuna Gjakovës nga buxheti i saj vjetor i vitit 2018, financon këtë projekt në shumën prej **100,058.00 €**,

Neni 3 Obligimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

1. MAPL-ja i zotën mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin **“Ndërtimi i rrugës lokale në Qafë Prush”** nga MAPL, do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, në rastin e bashkëfinancimit të projektit pagesat e para bëhen nga mjetet e zotuaratë buxhetit të MAPL-së.
3. MAPL cakton një zyrtar monitorues lidhur me këtë projekt, i cili në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MAPL-së.

Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna është e obliguar që pas pranimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe të protokolluar të hartoj projektin zbatues si dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim. Komuna pasi t'i ketë kryer këto procedura dërgon në MAPL shënimet e nevojshme për hartimin e PIP-it, me qëllim që MAPL të fillon me procedurat e sigurimit të zotimit të mjeteve të dalatë nga kjo marrëveshje e mirëkuptimit.
2. Komuna obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit, dhe një kopje ta dërgoj në MAPL.
3. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloj në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.

4. Palët janë pajtuar që Komuna të jetë bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit.
5. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MAPL, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).
6. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bënë inspektimin final të punimeve/pranimin teknik;
7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik, lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
8. Komuna obligohet që të njoftoj MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventuale të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga MAPL (për pjesën e financuar nga MAPL).
9. Komuna duhet të vendos tabelën informuese (Panon) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vend punishte.
10. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë gjatë vitit buxhetor 2018. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
11. Komuna është e obliguar të njoftoj MAPL-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.
12. Komuna obligohet që të dërgoj një konfirmim zyrtarë në MAPL, me të cilin njofton se projekti ka përfunduar.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për t'i realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera deri në shumën e financimit nga ana e MAPL-së, të kompletoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
 - 1.2 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimin nga ana e Komunës;
 - 1.3 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimin mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet);

- 1.4 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga MAPL;
- 1.5 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
- 1.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6

Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MAPL-së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MAPL-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim.


Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetari i Komunës.

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Ivan Todorosijević,
Ministër në MAPL-së



Ardian Gjini,
Kryetari i Komunës së Gjakovës





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Priština, _____, 2018

Br. 454-35

Na osnovu člana 4., 21. i 22. Zakona br. 03/L-189 o državnoj upravi Republike Kosova, (službeni list, br. 82. 21. oktobar 2010. godine), član 8. stav 1.4. Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, član 5. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Zakona br. 06/L-020 o budžetu Republike Kosova za 2018. godinu, sklapa se ovaj:

**SPORAZUM O RAZUMEVANJU ZA SUFINANSIRANJE PROJEKTA " IZGRADNJA
LOKALNOG PUTA U QAFË PRUSH " OPŠTINA ĐAKOVICA**

Potpisnici

1. Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave MALS (u daljem tekstu MALS),
i,
2. Opština Đakovica koju predstavlja gradonačelnik opštine, (u daljem tekstu opština).

Član 1.

Cilj

Cilj ovog sporazuma je sufinansiranje projekta " **Izgradnja lokalnog puta u Qafë Prush** ", kao i utvrđivanje obaveza MALS-a i opštine Đakovica, za realizaciju ovog projekta.

Član 2.

Vrednost projekta i način finansiranja

1. Projekat " **Izgradnja lokalnog puta u Qafë Prush** " ima vrednost predračuna u iznosu od **208,058.00 €**.
2. MALS iz svog godišnjeg budžeta 2018 godine, finansira ovaj projekat u iznos od **108,000.00€**.
3. Opština **Đakovica** iz svog godišnjeg budžeta 2018. finansira ovaj projekat u iznos od **100,058.00 €**,

Član 3.

Obaveze Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave

1. MALS obavezuje sredstva za projekat iz člana 2. stava 2. ovog sporazuma i jednu kopiju šalje se opštini.
2. Plaćanje projekta " **Izgradnja lokalnog puta u Qafë Prush** " od strane MALS-a biće izvršeno na osnovu realizacije radova/snabdevanja u skladu sa uslovima ugovora, u slučaju sufinansiranja projekta, prva uplata se vrši od obavezanih sredstava budžeta MALS-a.
3. MALS imenuje službenika za nadgledanje ovog projekta, koji tokom realizacije ovog projekta, ukoliko primeti nepravilnosti ili nedostatke tokom realizacije ovog ugovora, obaveštava rukovodstvo MALS-a.

Član 4.

Obaveze opština

1. Opština je obavezna da, nakon prijema potpisanog i protokolisanog sporazuma o razumevanju, izradi projekat implementacije i da obezbedi svu potrebnu dokumentaciju da projekat neće imati nikakve prepreke u realizaciji. Po završetku ovih procedura, Opština šalje MALS-u neophodne podatke za izradu PJI, kako bi MALS počeo sa procedurama dodele sredstava koja proizilaze iz sporazuma o razumevanju.
2. Opština je obavezna da obezbedi izjavu o raspoloživosti sredstva u celini procenjene vrednosti projekta i jednu kopiju da dostavi MALS-u.
3. Opština je dužna da razvije projekat u skladu sa Zakonom br. 04/L-042 o javnim nabavkama na Kosovu, izmenama i dopunama Zakona br. 04/l-237, Zakonom br. 05/l-068, Zakonom br.05/l-092 i Zakonom br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima, kao i podzakonskim aktima.

4. Strane su se složile da opština treba da bude nosilac svih procedura nabavke.
5. Opština je dužna da posle potpisivanja ugovora sa ekonomskim operaterom dostavi jednu kopiju ugovora identičnu sa originalom u MALS-u, zajedno sa poslovnim informacijama, radi dobijanja izdavanja naloga za kupovinu (broj biznisa i broj računa).
6. Opština imenuje rukovodioca/nadzornog organa za realizaciju projekta i vrši konačnu inspekciju radova /tehničkog prijema;
7. Rukovodilac/nadzorni organ projekta s potpunom odgovornošću proverava količinu i kvalitet rada /izvršeno snabdevanje na osnovu kojih ekonomski operator izdaje finansijski dokument sa zahtevom za plaćanje radova /izvršenih snabdevanja na osnovu uslova ugovora.
8. Opština je obavezna da informiše MALS za svaki predlog, eventualne promene količine i kvaliteta tokom realizacije projekta, dok za dodatne radove treba da traži odobrenje od strane MALS-a (za deo koje finansira MALS).
9. Opština bi trebalo da uspostavi standardizovanu informativnu tablu (Pano) sa projektnim napomenama, investitorima i ekonomskim operaterima na mesto gde se vrše radovi.
10. Opština treba da preduzme sve mere da završi projekat tokom budžetske 2018. godine. Nakon ovog roka sve obaveze se prenose na odgovornost opštine.
11. Opština je obavezna da obavesti MALS o realizaciji projekta prema dinamici radova do kraja projekta.
12. Opština je obavezna da šalje zvaničnu potvrdu MALS-u, kojom izveštava da je projekat završen.

Član 5.

Potrebna dokumentacija za plaćanje od strane opštine

1. Opština je obavezna da popuni sledeću dokumentaciju za izvršenje plaćanja za radove izvršeno snabdevanje do iznosa koji finansira MALS:
 - 1.1 Kopija ugovora potpisanog zajedno sa opštim i posebnim uslovima i finansijskom ponudom identičnom sa overenim originalom od strane rukovodioca nabavke opštine;
 - 1.2 Odluka o imenovanju rukovodioca projekta/nadzornog organa/komisije o prihvatanju od strane opštine;
 - 1.3 Izveštaj rukovodioca projekta/nadzornog organa/komisije za prijem izvršenih i odobrenih radova/snabdevanja (situacije);
 - 1.4 Originalni račun od ekonomskog operatera i odobrena situacija do iznosa koji finansira MALS;

- 1.5 Osiguranje izvršenja, osiguranje kvaliteta sa tehničkim prijemom po uslovima ugovora;
- 1.6 Kopija biznis sertifikata, račun od banke i lična karta vlasnika ekonomskog operatera (ako nije registrovan u KISUF- ministarstvo finansija).

Član 6.

Vlasništvo nad projektom

1. Po preuzimanja izvršenih radova od strane ekonomskog operatera, ova investicija (projekat) od ovog sporazuma o razumevanju prelazi u vlasništvo opštine.
2. Ova investicija registruje se u opštinsku imovinu na elektronski i fizički način, u sistemu imovine ministarstva finansija (KISUF).

Član 7.

Izmene i prestanak sporazuma o razumevanju

1. Uz prethodnu saglasnost ministra MALS-a i gradonačelnika opštine ugovor se može izmeniti i dopuniti.
2. MALS ima pravo da raskine ugovor ukoliko utvrdi da opština ne ispunjava svoje obaveze prema ovom ugovoru.

Član 8.

Rešavanje spora

Strane su se složile da sporove treba rešiti uz dobro razumevanje.


Član 9.


Stupanje na snagu

Ovaj sporazum stupa na snagu nakon potpisivanja od strane ministra MALS-a i gradonačelnika opštine.

Memorandum o razumevanju potpisan je u dva (2) originalna primerka, po jedan primerak za svaku stranu potpisnicu.

Ivan Todosijević,
Ministar MALS-a

24 



Edrian Gjini,
Gradonačelnik Opštine Đakovica

